

AKT – THEMELIMI I SHOQËRISË

"Leader Clinic International" SH.P.K

Sot, me 04/08/2024, une, themeluese, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Leader Clinic International" Sh.p.k

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Buse Teke**, atësia Cengiz, amësia Banu, shtetase Shqiptare, lindur në TURQI, Turqi (TUR) dhe banuese në TIRANË, me adresë Karl Gega; Nd. 36; H. 1; Ap. 29; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 11/07/1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 279000 dhe nr. personal J88711001C
- **Muhammed Talha Durmus**, atësia Umit, shtetas Turk, lindur në Stamboll dhe banues në Turqi, me adresë Fatih mahallesi 234, Sokak no 26, Turqi, lindur më 15/07/2000, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte me nr. 16990506590

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Rregjistrimin e Biznesit", kam vendosur te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar "Leader Clinic International", duke nenshkruar kete Akt Themelimi.

NENI 1


EMËRIMI DHE LLOJI I SHOQËRISË

Shoqëria e formuar do të emërohet "Leader Clinic International" dhe do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë me adresë: Rruga "Don Bosko", Hyrja 1 Apartamenti 6, Pasuria Nr. 9/805+1-6, ZK 8330, Njesia Administrative Nr. 9, Tirane.



NENI 3

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë "**Leader Clinic International**" është :

Klinik Estetike, Sherbime Dermokozmetike, Dermatologjike, Lazer, Filler, Transplant i flokve, mjekres dhe vetullave, trajtime të fytyres dhe trupit dhe masazhe të ndryshme. Import-Eksport, tregtim me shumice e pakice barnave dhe produkteve kosmetike. Tregtimi me pakice dhe shumice të produkteve të ndryshme dhe produkteve kozmetike (kremra) dhe nenproduktet e saj. Trajnime dhe kurse profesionale që lidhen me fushën e mjekësisë. Konsulenc, Asistenc apo sherbime të ndryshme në fushën mjeksore dhe të paisjeve të ndryshme. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndermarre dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, promociional që i vlereson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali fillestar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë lekë), i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet menjehere dhe do të paguhet nga ortakët që zoterojnë 100% (një qind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht :

- Z.n. **Buse Teke**, shtetase Shqiptare, lindur në TURQI, Turqi (TUR) dhe banuese në TIRANË, me adresë Karl Gega; Nd. 36; H. 1; Ap. 29; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 11/07/1998, e pajisur me dokumentin e identitetit, ID, me Nr.Personal: J88711001C, e cila zoteron 50% (Pesë dhjetë) të kapitalit.
- Z. **Muhammed Talha Durmus**, shtetas Turk, lindur në Stamboll dhe banues në Turqi, me adresë Fatih mahalles 234, Sokak no 26, Turqi, lindur më 15/07/2000, i pajisur me dokumentin e identitetit, Pasaporte me nr. 16990506590, i cili zoteron 50% (Pesë dhjetë) të kapitalit.



NENI 6

KONTRIBUTI I ORTAKEVE

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Ortakët mund të vendosin për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 7

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të funksionojë me një afat kohor të pakufizuar. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit

NENI 8

ADMINISTRIMI I FITIMEVE

Fitimet e realizuar kalojnë në pronësi të ortakve themelues.

Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

NENI 9

ORGANET E SHOQËRISË

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori

1. Administratori

Mënyra e organizimit dhe funksionimit është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Administratori i shoqërisë do të jetë :

- **Buse Teke**, atësia Cengiz, amësia Banu, shtetase Shqiptare, lindur në TURQI, Turqi (TUR) dhe banuese në TIRANË, me adresë Karl Gega; Nd. 36; H. 1; Ap. 29; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 11/07/1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 279000 dhe nr. personal J88711001C

NENI 10

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

NENI 11
MARDHËNIET E PUNËS

Mardhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

NENI 12
KONFIDENCIALITETI

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratorët e kësaj shoqërie.

NENI 13
PJESËMARRJA NË SHOQËRI OSE AKTIVITETE TË TJERA

Ortakët e shoqërisë nepermjet Asamblese se Pergjithshme mund të vendosin për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera, futjen e personave të tjerë si ortakë të shoqërisë dhe të krijojnë cdo lloj aktiviteti tjetër privat, por jo konkruues me atë të shoqërisë së themeluar prej tij.

NENI 14
LIKUIDIMI I SHOQËRISË



Nëse shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrrojë një bilanc likuidimi për miratim.

NENI 15
EKSPERTËT DHE REVIZORËT KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizor kontabël i caktuar nga asambleja. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

NENI 16
BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE

Veprimtaria ekonomike vjetore e shoqërisë do të mbyllet në datën 31 Dhjetor të cdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si më sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten i kalojnë ortakve sipas aksioneve dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.



NENI 17

LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga statuti i shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 18

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 19

DISPOZITA TË FUNDIT

Akti Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

ORTAKET

Buse Teke Buse Teke

Buse Teke

ORTAKET

Muhammed Talha Durmus

Muhammed Talha Durmus

Muhammed Talha Durmus